



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:097967

Datë: 01.07.2024

Numri i dokumentit: 05920570

**PKR.nr.335/22**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, në përbërje nga gjyqtarja Sulltane Hoti, kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve profesionistë Alban Ajvazi dhe Avni Sylja, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arxhenita Vokshi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit K.B, për shkak të veprës penale në vazhdimësi, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.3 pika 1 lidhur me par.1 dhe nenin 77 të KRPRK-së dhe veprës penale në vazhdimësi, Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore nga neni 394 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.37K/22 të dt.24.06.2022, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, me dt.29.05.2024 në të cilin ishin prezent Prokurori i shtetit B.Z, i akuzuari K.B me mbrojtësin e tij sipas autorizimit Av.R.G, i dëmtuari I.K, me datë 05.06.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 01.07.2024 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

**K.B**, i biri i J..., dhe nënës Sh..., e gjinisë H..., i lindur me dt....., në Prishtinë, me vendbanim në rrugën "F.V" nr..., hyrja nr... Prishtinë, me nr. personal:....., ka të fakultetin Etnologjisë, në UP, Mastar komunikim me media, punon në K.K për Trashëgimi Kulturore në pozitën zëvendës i Udhëheqësit Ekzekutiv, i martuar baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP të Republikës së Kosovës,**

### **LIROHET NGA AKUZA**

**Sepse:**

**I.** I akuzuari K.B, në cilësinë e personit zyrtar, si Zëvendës i Udhëheqësit Ekzekutiv në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, duke e shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, në mënyrë të vazhdueshme nuk i ka përmbush detyrat zyrtare, me qëllim që t'i shkaktojë dëm të dëmtuarit I.K, në atë mënyrë që, në kundërshtim me Vendimin me nr.14/21, të datës 09.09.2021, të marr nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ku në bazë të këtij vendimi i dëmtuari është emëruar në pozitën e kategorisë së mesme drejtuese Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Materiale, me koeficiente 10, i akuzuari në

kundërshtim me Vendimin me nr.14/21, të datës 09.09.2021 dhe Aktemërimin AE.Nr.04/2021, nuk e ka vendos të dëmtuarin Drejtor të Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Materiale në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe në listën e pagave me koeficientin 10 të dëmtuarin I.K, por e ka dërguar në pozitën e divizionit (nivelit të ulët drejtues) me koeficient 9, edhe pse në bazë të formularit të PCF4 për buxhetin për vitin 2021, ka pas mundësi buxhetore me zbatuar vendimin dhe me vendos në listën e pagës më koeficient 10, kështu që i shkakton dëm të dëmtuarit në mënyrë të vazhdueshme për çdo muaj në vlerë prej 60.60 euro në muaj,-

-sepse nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale në vazhdimësi, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.3 pika 1 lidhur me par.1 dhe nenin 77 të KRPRK-së.

**II.I** akuzuari K.B, në cilësinë e personit zyrtar, si Zëvendës i Udhëheqësit Ekzekutiv në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, nga data 14.02.2022 e deri më tani, refuzon të ekzekutojë Vendimin A.nr.3130/21, e datës 10.01.2022, të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, si dhe Vendimin AA.nr.87/2022, të datës 14.02.2022, të nxjerrë nga Gjykata e Apelit, me të cilat vendime obligohet i akuzuari ta zbatoj Vendimin A.nr.902/2021, e datës 17.05.2021, të nxjerrë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,-

-sepse nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale në vazhdimësi, Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore nga neni 394 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, konform nenit 453 par.1 të KPRK-së.

I dëmtuari I.K, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

### *Rrjedhja e procedures:*

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda ka ngritur aktakuzën me numër PP.I.nr.37K/2022 të dt.24.06.2022, ndaj të akuzuarit K.B, për shkak të veprës penale në vazhdimësi, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.3 pika.1 lidhur me par.1 dhe nenin 77 të KRPRK-së dhe veprës penale në vazhdimësi, Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore nga neni 394 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit të akuzuarit iu dha mundësia e deklarimit të tij lidhur me aktakuzën, i njëjti u deklarua i pafajshëm për veprat penale e të cilat i viheshin në barrë sipas aktakuzës.

Pasi që i akuzuari nuk e pranoi fajësinë për veprat penale të cilat i viheshin në barrë sipas aktakuzës, gjykata vazhdoi me paraqitjen e radhës së provave në shqyrtimin gjyqësor, me fjalën hyrëse të palëve, me dëgjimin e dëshmitarëve, me administrimin e provave materiale, me mbrojtjen e të akuzuarit si dhe me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit fjalën e tij përfundimtare e ka dorëzuar me shkrim, të njëjtën e ka elaboruar në pikë të shkurtra në të cilën ka deklaruar se aktakuza e ngritur është e mbështetur në provat e siguruara me të cilat rezulton se i akuzuari K.B i kishte kryer veprat penale për të cilat akuzohet si në dispozitiv të akuzës, vërtetimi i plotë dhe i drejtë i gjendjes faktike si në aktakuzë është vërtetuar nga provat materiale të siguruara gjatë procedurës së hetimeve, gjatë shqyrtimeve gjyqësore pranë gjykatës, bindshëm është vërtetuar se i akuzuari K.B me veprimet të përshkruara si në dispozitivin e aktakuzës ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Nga provat materiale vërtetohet që K.B kishte kryer veprat penale me të cilat ngarkohet, prova këto të elaboruara në aktakuzë dhe të administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore, ku është dëgjuar i dëmtuari Jusuf Koci, si dhe janë dëgjuar dëshmitarët dëshmitarët A.S, H.D, Sh.R dhe Z.H. Nga përmbledhja e dëshmisë së dëshmitarit H.D, është vërtetuar gjendja faktike se në buxhetin e vitit 2021 kishin qenë dy koeficiente me 10, që vërteton faktin që i akuzuari K.B kishte pasur mundësi që ta zbatoj vendimin që I.K të paguhej me koeficient 10, po ashtu ishte vërtetuar fakti se si KPMSHC-ja, ja kishte ndaluar pagën prej 50% të pandehurit K.B, pasi i njëjti nuk e kishte zbatuar vendimin. Nga dëshmia e dëshmitares Sh.R, zyrtare e MPB-së, është vërtetuar fakti se KKTK-ja është Institucion i Pavarur dhe se nuk kishte obligim të merrte aprovimin e MPB-së. Nga dëshmia e dëshmitares Z.H, Kryetare e Bordit të KKTK-së, është vërtetuar fakti se i akuzuari K.B, në cilësinë e Zëvendësit të Udhëheqësit Ekzekutiv, nuk ishte duke e zbatuar vendimin nr.14/2021 të datës 09.09.2021, të Njësisë së Burimeve Njerëzore të KKTK-së, Vendimin e KPMSHC-së, A.nr.902/2021, i datës 17.05.2021, Vendimin A.nr.3130/2022, i datës 10.01.2022, të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Vendimin AA.nr.87/2022, i datës 22.02.2022, të nxjerrë nga Gjykata e Apelit, për emërimin e të dëmtuarit I.K në pozitën e Udhëheqësit të Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Materiale, me koeficient 10. Në bazë të gjendjes faktike dhe provave të administruara është vërtetuar se Vendimi për emërimin e nëpunësit civil në kategorinë e mesme drejtuese për I.K., në pozitën e drejtorit të Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Materiale, e lëshuar nga Burimet njerëzore të KKTK-së, i datës 09.09.2021, është në pajtim me ligjin për zyrtarët publik, dhe rregulloret përkatëse. Gjykatës i propozoj që me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, e duke vepruar konform dispozitës së nenit 70 par.2 dhe par.3 të KPRK-së, ndaj të pandehurit K.B, të vlerësoj rrethanat rënduese dhe lehtësuese në përcaktimin e llojit të lartësisë së dënimit, si dhe dënimi i shqiptuar ndaj tij të jetë në mbështetje edhe me Udhëzimet e Politikës Ndërkombëtare, të ketë parasysh shkallën e lartë të përgjegjësisë penale, i njëjti është person zyrtarë ku i janë besuar funksione të rëndësishme në funksionimin e institucionit, për tri kërkesa që i kishte dërguar zyrtari i Burimeve Njerëzore A.S, dy i kishte përfunduar, rregullimin e pagës për vete dhe kërkesën e A.S, ndërsa për të dëmtuarin I.K jo, tek i akuzuari ka ekzistuar dashja e lartë me qëllim për të kryer veprën penale, kishte qenë i vetëdijshëm për veprimet e tij, mosbindja ndaj Institucioneve të pavaruara të shtetit siç është KPMSHC. Prokuroria nuk kishte hasur në ndonjë rrethanë lehtësuese e cila do të merrej në konsideratë rreth kësaj çështje penale. Nga veprimet e ndërmarra nga i akuzuari manifestohen elementet e veprës penale për të cilën akuzohet i akuzuari. Andaj propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I dëmtuari I.K në fjalën e tij përfundimtare të cilën e ka përgatitur me shkrim, ka deklaruar se e përkrah fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, ka parashtruar kërkesë pasurore juridike, ka shtuar se K.B qëllimisht me dashje i kishte mohuar të drejtën ligjore të sistemohej si Drejtor në Departamentin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale, kjo është vërtetuar gjatë procesit gjyqësor, përmes fakteve dhe dëshmimeve konkrete të cilat janë administruar, pozita si Drejtor në Departamentin për Mbrojtjen e TKM, kishte qenë e drejtë e tij ligjore që i kishte takuar, e njëjta i ishte mohuar nga i akuzuari K.B, për këtë arsye kishte ndjekur rrugën ligjore, përmes kërkesave dhe ankesave. KPMSHC, me datë 17.12.2021, me Aktvendimin

A.nr.902/2021, e kishte obliguar K.B që të njëjtin ta sistemonte në pozitën e Drejtorit të Departamentit për MTKM, dhe të ja kompensonte diferencën e pagës nga data 09.09.2021, ndërsa K.B kishte pasur të drejtën ligjore që të ushtronte ankesë në GJTHP, ankesa nuk e ndalte ekzekutimin e vendimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.R.G në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se fillimisht e kundërshtojë fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe vlerësojë se e njëjta është e pa qëndrueshme, propozojë që gjykata të mos e merr parasysh me rastin e vendosjes në këtë çështje penale. Veprat penale me të cilat akuzohet i mbrojturi i tij janë vepra që shkaktohen me dashje, me qëllim paraprak që veprimi të jetë i kundërligjshëm dhe që duke vepruar kundërligjshëm të cenohet e drejta e tjetrit dhe të shkaktohet pasoja e cila po ashtu paraprakisht sipas elementeve të veprës penale është dashje direkte të kryerësit të veprës penale. Asnjë nga këto elemente inkriminuese të cekura por edhe çdo element tjetër që rregullon dhe precizon ligji për veprat penale që akuzohet i mbrojturi i tij nuk manifestohen në asnjë moment në veprimet e të mbrojturit të tij, K.B deri sa për këtë çështje kryente detyrën e Zëvendës Udhëheqësit Ekzekutiv të KKTK. Vendimi për të cilin pretendon akuza ishte marrë shumë pak ditë para se i mbrojturi i tij nga Bordi i Këshillit ishte zgjidhur edhe ishte caktuar në këtë detyrë. K.B sipas asaj që ka dal në shqyrtimin gjyqësor askush nga Këshilli nuk kishte qenë në dijeni për vendimin nr.14/2021 dt.09.09.2021, për këtë vendim edhe i mbrojturi i tij kishte marr ose kishte kuptuar 2 apo 3 muaj a më shumë, pasi kishte pranuar detyrën dhe me këtë rast kishte konstatuar se vendimi ishte krejtësisht në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e procedurës së brendshme dhe aktet e Këshillit. Personi që e kishte sjellë vendimin pas dy dite e kishte pezulluar marrëdhënien e punës dhe pastaj nga K.B dhe nga vet Bordi i Këshillit ishte konstatuar se për vendimin kontestues nuk ishte i njoftuar Bordi i Këshillit e që ishte e paraparë me dispozitën e nenit 9.5 të rregullores 2016/01 të Këshillit. Po ashtu kjo çështje ishte e rregulluar edhe me nenin 9.12 të kësaj rregullore dhe po ashtu edhe kjo dispozitë nuk ishte marr për bazë e as nuk ishte respektuar me rastin e marrjes së atij vendimi. Sikurse Bordi i Këshillit edhe K.B kishin konstatuar se pozita për të cilën ishte nxjerr vendimi kontestues nuk ekzistonte fare në kuadër të Këshillit dhe nuk ishte paraparë një pozitë e tillë për të cilën ishte nxjerrë një vendim i tillë për I.K, po ashtu kishin konstatuar se nuk ekzistonte edhe lista për koeficient 10 për pozitën për të cilën kishte pretenduar vendimi i I.K dhe nuk ka pas as nuk ka ekzistuar pagesa nga thesari për këtë arsye nuk ka mundur as të bëhet, po ashtu edhe organet tjera kompetente departamentet apo divizione si janë quajtur për zyrtar publik nuk kishte fare procedurë dhe nuk kishte as kërkesa fare, pra këto janë arsyet që K.B e kanë penguar të veprojnë sipas vendimit 14/2021 i cili për nga mënyra e sjelljes dhe për shkak të mos respektimit të asnjë procedure si brenda këshillit edhe ashtu jashtë këshillit ishte nule pra i kundërligjshëm dhe si i tillë as që mund të zbatohet. Shtoi se i kanë sjellë disa prova gjatë shqyrtimit kryesor të cilat para gjykatës janë administruar dhe nga të cilat plotësisht vërtetohen pretendimet e mbrojtjes për sa i përket faktit vendimit kontestues ishte i kundërligjshëm dhe ishte i pamundur të zbatohet dhe në fakt zbatimi i njëjti do të paraqiste shpërdorim të detyrës zyrtare. Me këtë rast përmendi vendimin e KPMSHCK për anulimin e konkursit me të cilin ishte emëruar udhëheqës ekzekutiv I.K, si Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit për anulimin e procedurave për rekrutimin për Udhëheqësit Ekzekutiv për rastin e I.K, Vendimi për anulimin për akt emërimin për Drejtor të Departamentit për I.K, Vendimin me të cilin shfuqizohet vendim i mëhershëm për ndalesën e pagesës prej 50 % të ardhurave personale për K.B, Vendimin e Bordit të KKTK-së për anulimin e konkursit për zgjedhjen e I.K si udhëheqës ekzekutiv, Vendimin për anulimin e akt emërimin për I.K si drejtor, Vendimin për shfuqizimin e vendimit për zgjedhjen drejtor të I.K, Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për anulimin e vendimit për dënimin për K.B, shtrohet pyetja pse u proceduan të gjitha këto vendime dhe procedura dhe nuk janë të gjitha nga ato që përmendi më lartë dhe arsyeja e vetme është sepse të gjitha organet kompetente të kyçura në këtë shqyrtim më vonë

ishin ardhur në përfundim të qartë se edhe vendimi në dispozitivin e aktakuzës për të cilën pretendon akuza pra vendimi me nr.14/2021 i dt. 09.09.2021 ishte i kundërligjshëm duke mos respektuar asnjë procedurë ligjore dhe nënligjore e po ashtu edhe proceduar të cilat ndërkohe ishin udhëhequr ndaj K.B rezultuan të ishin të padrejtat për çka edhe u anuluan, dhe sa i përket dispozitivit të dytë të aktakuzës mbrojtja vlerëson se ky dispozitiv është i paqëndrueshëm dhe farë nuk ka të bëjë me elementet e veprës penale nga neni 394 par.1 të KPRK-së dhe arsyeja e thjesht sepse nuk ka të bëjë me mos zbatim të vendimit gjyqësor por ka pasur të bëjë më vetëm me propozimet e prolongimit e afateve, në fund gjykatës i propozoj se në mungesë të fakteve që i mbrojturi i tij ka kryer veprat penale si në aktakuzë i njëjti të lirohet nga akuza.

I akuzuari K.B në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe shtoi se edhe vendimi i KPMSHC me të cilën i është aprovuar fillimisht edhe ai është anuluar dhe po ashtu shtoi se nuk ka pasur ligjshmëri mbajtja e pozitës nga I.K dhe për këtë dëshmojnë të gjitha vendimet e Gjykatës edhe Themelores dhe Apelit si dhe zyrës së Kryetares së Gjykatës që do të thotë se nuk i ka gëzuar privilegjet fillimisht për të ardhur deri tek ai vendim si dhe nuk e ka dëmtuar I.K edhe procedurat e mëvonshme e kanë vetëtuar se i akuzuari ka pasur të drejtë, si dhe kur Prokurori i Shtetit kur e përmendi koeficientin 10, i'a kujton prokurorit se ka ekzistuar edhe koeficienti 9 të cilin e ka pasur I.K, dhe se koeficienti nuk e përcakton automatikisht pozitën, në fund kërkojë nga gjykata që ta lirojë nga kjo aktakuzë.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, në cilësi të dëshmitarëve në këtë shqyrtim gjyqësor ka dëgjuar të dëmtuarin-dëshmitarin I.K si dhe dëshmitarët Sh.R, A.S, H.D dhe Z.H, si dhe ka administruar prova materiale.

a) Gjykata ka administruar provat materiale të propozuara nga Prokurori i shtetit dhe atë si në vijim:

- Vendimi për emërimin e nëpunësit civil në pozitën e kategorisë së mesme drejtuese I.K në pozitën Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimi Kulturore, i datës 09.09.2021;
- Aktmrimi i I.K, në pozitën Udhëheqës i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale, e lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, i datës 09.09.2021;
- E-mail i datës 09.09.2021 me titull "Pranimi i pozitës së ofruar nga Njësia e Burimeve Njerëzore", e dërguar nga I.K, për A.S, zyrtar i Njesisë së Burimeve Njerëzore;
- E-mail i datës 01.11.2021, me titull "Kërkesë për Ndryshimin në listën e pagave" e dërguar nga ankuesi I.K, për të pandehurin K.B;
- E-mail i datës 11.11.2021, me titull "Re: Kërkesë për Ndryshimin në listën e pagave" i dërguar nga ankuesi I.K, për të pandehurin K.B;
- E-mail i datës 30.12.2021, i dërguar nga K.B, për H.D me titull "Sqarim";
- Procesverbal i mbledhjes së anëtarëve të bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore i datës 20.10.2021;
- E-mail i datës 31.12.2021, i dërguar nga H.D për K.B, me titull "Sqarim";
- Formulari i Shpenzimeve të Departamentit, Divizionit ose Sektorit, i datës 01.11.2021(formulari PCF4);
- Formulari i të dhënave për Listën e pagave I.K;
- Vendimi A.nr.902/2021, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilin ju është aprovuar ankesa e të dëmtuarit I.K;
- Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr.3130/21;
- Aktvendimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA.Nr.87/22;
- Vendimin për ndalimin e 50% të pagës mujore për të pandehurin K.B, me nr.03/2022 e datës 14.02.2022, për shkak se i njëjti nuk ka zbatuar Vendimin e KPMSHC-së;

-E-mail i datës 07.06.2022, ku Zyrtari Kryesor Financiar H.D, ju ka përgjigj kërkesës së K.B, në lidhje me mundësinë e zbatimit të vendimit të KPMSHC-së;

b).Gjykata po ashtu ka administruar provat materiale të propozuara nga mbrojtësi i të pandehurit K.B av.R.G dhe atë si në vijim:

-Vendimi i KPMSHCK-së, A.nr.257/2018 i dt.19.06.2018, me të cilin e anulon konkursin me të cilit është emëruar Udhëheqës Ekzekutiv I.K;

-Aktvendimi Ac.nr.1563/2019 i dt.18.12.2020, nga Gjykata e Apelit-shfuqizon vendimin A.nr.1827/18 të Gjykatës Themelore dhe vërteton vendimin të KPMSHCK-së për anulimin e konkursit;

-Urdhër përmbarimi Cp.nr.1516/18 i dt.19.01.2021 Gjykata Themelore Prishtinë që ka ardhur si vazhdimësi e vendimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.1563/2019;

-Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.nr.574/2021 i dt.07.06.2022, për anulimin e procedurave për rekrutimin e Udhëheqësit Ekzekutiv;

-Vendimi Akti nr.16/22 i Bordit;

-Vendimi Akti nr.17/2022 i KKTK-së i cili anulon Aktemrimin për pozitën e Drejtor Departamenti për I.K;

-Vendimi KMPSHCK-së i dt. 08.08.2022 për shfuqizimin e vendimit nr.03/2022 të KPMSHCK-së për ndalesën e pagesës së pagës prej 50% për K.B;

-Vendimi A.nr.753/2022 i KPMSHCK-së i dt. 28.10.2022 Shfuqizon Vendimin A.nr.902/2021 të datës 17.12.2021 në bazë të cilit pa drejtë akuzohet K.B kinse për moszbatim të vendimit gjyqësor e po ashtu vërtetohet Vendimi nr.17/2022 i datës 03.08.2022 të KKTK-së për anulimin e Aktvendimit për pozitën drejtuese Drejtor Departamenti për I.K;

-Vendimi i Bordit të Këshillit për Trashëgimi Kulturore Akti.nr.16/2022 i datës 28.07.2022, për anulimin e konkursit për zgjedhjen I.K, drejtor përkatësisht udhëheqës ekzekutiv;

-Vendimi i Këshillit për trashëgimi kulturore Akti.nr.17/2022 i datës 03.08.2022 mbi ANULIMIN e akt emërimit të I.K si Drejtor;

-Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, A.nr.753/2022, i datës 28.10.2022, pika III, për shfuqizimin e Vendimit për zgjedhjen Drejtor të I.K;

-Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Nr.69/2022 i datës 08.08.2022, për anulimin e dënimit për K.B;

-Dokumentet e komunikimit nga vërtetohet se I.K, duke pasur parasysh provat e cekura më lartë, pranon pozitën më të ulët se ajo për të cilën akuzohet K.B.

c).Po ashtu në këtë shqyrtim gjyqësor janë administruar si prova materiale edhe provat e dorëzuara nga i dëmtuari I.K, dhe atë si në vijim:

-Procesverbali i Këshillit të Kosovës të Trashëgimisë Kulturore e datë 08.09.2021 ku specifikohet se bordi me 5-vota për dhe një kundër ka vendosur që të hap konkurs për Pozitën e Udhëheqësit Ekzekutiv, pozitë të cilën e ka mbajtur i dëmtuari, këtë procesverbal e ka hartuar vetë i dëmtuari sepse ka qenë i autorizuar me mbajt dhe ka qenë prezent aty mirëpo kur është diskutuar kjo pikë Bordi ka kërkuar që i dëmtuari të mos jetë prezent, ndërsa mbledhja është e regjistruar me video;

-E-mali që i dëmtuari iu ka drejtuar K.B me kërkesë për qasje në dokumente e datës 12.10.2021, e cila ka pas të bëjë me formular me ndryshim të pagave dhe nuk ka marr përgjigje dhe rrjedhimisht nuk i është mundësuar qasja në ato dokumente;

-Vendimi A-258-2021 i datës 20.12.2021, me të cilin i dëmtuari ju ka drejtuar Agjencisë për Informim dhe Privatësi ku e ka aprovuar ankesën e tij dhe e ka detyruar palën që t'i ofrojë dokumentet si në vijim; Vendimi A.nr.565-2022, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës i datës 05.08.2022, me të cilin ka aprovuar ankesën e tij dhe e ka obliguar udhëheqësin ekzekutiv të KKTK-së, që t'ia njeh të drejtën e tij për pushim.

I dëmtuari-dëshmitari I.K, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nga viti 2009 kishte mbajtur pozitën e administratorit me kontratë mbi vepër, në vitin 2010 asistent ekzekutiv në të njëjtin vit ka vazhduar si Zyrtar i Lartë për Trashëgimi të Luajtshme deri në vitin 2015, gjatë kësaj periudhe (2014-2015) kishte mbajtur edhe pozitën e ushtruesit të detyrës së drejtorit të Departamentit për Trashëgimi Kulturore, në vitin 2015, ishte udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Pasurisë Materiale, në vitin 2016, kishte qenë ushtrues detyre i Udhëheqësit Ekzekutiv, në vitin 2018, ishte zgjedhur si udhëheqës ekzekutiv deri në vitin 2021, ndërsa me datë 09.09.2021, ishte caktuar si drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Materiale nga Njësia e Burimeve Njerëzore, të cilën pozitë nuk e kishte ushtruar asnjëherë, kurse në gusht të vitit 2022, ishte nxjerrë një vendim tjetër nga Njësia e Burimeve Njerëzore ku është anuluar vendimi për caktimin e tij si drejtor Departamentit dhe ishte caktuar si udhëheqës i divizionit, në këtë kohë e kishte pozitën si Udhëheqës Divizioni, pas mbarimit të mandatit të tij si Udhëheqës Ekzekutiv, me datën 08.09.2021, bordi i KKTT, kishte marrë vendim që mos të rizgjidhet edhe një herë në këtë pozitë dhe kishte hapë konkursin. Për këtë vendim Bordi e kishte njoftuar NBN që nuk është vazhduar mandate për I.K dhe do të hapej konkursi, atëherë i njëjti kishte pranuar një njoftim nga Njësia e Burimeve Njerëzore, ku ishte kërkuar që të deklarohet se a pranon të caktohet në pozitën e drejtorit të Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Materiale-pozitë e nivelit të mesëm drejtues, dëshmitari e kishte pranuar që të sistemohet në këtë pozitë me datë 09.09.2021, i përcaktuar në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe Rregullores për Emërime të Larta, i cili specifikonte qartë se pas mbarimit të mandatit të një zyrtari të lartë drejtues Njësia e Burimeve Njerëzore ishte e obliguar që zyrtarin ta sistemojë në një pozitë të mesme drejtuese, gjë që e kishte bërë të jetë sistemuar në pozitën e cekur. Në fillim të muajit tetor apo nëntor, muaji pasues pas vendimit, paga pasuese i kishte dal me koeficient 9, ka kërkuar sqarim nga udhëheqësi ekzekutiv se pse paga e tij kishte dalë me koeficient 9 dhe jo me koeficient 10 siç ishte në bazë të aktemërimit, i njëjti nuk kishte marrë ndonjë sqarim, ka kërkuar edhe qasje në dokumentet publike, respektivisht në formularin e ndryshimit të listës së pagave, nga kush ishte bërë ky ndryshim dhe mbi çfarë baze ligjore. Fillimisht nuk i ishte lejuar qasja në këtë formular, pastaj e kishte shfrytëzuar të drejtën e tij që të parashtrij ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi që të ketë qasje në këtë dokumente i është aprovuar ankesa dhe se KKTK-ë i ka ofruar qasje këtë dokument-formular, i cili kishte qenë i nënshkruar nga K.B dhe L.A, e cila në këtë periudhë ishte caktuar si përgjegjëse e personelit, meqenëse nuk e kishin sistemuar në koeficientin që e kishte, dëshmitari e kishte shfrytëzuar të drejtën ligjore që të parashtrij ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e cila ankesë ishte aprovuar dhe KKTK ka qenë e obliguar që në afat prej 15 ditësh ta bëjë zbatimin e vendimit dhe ta sistemojë në listën e pagave dhe ti kompensohet diferenca nga muaji shtator, dhe atë nga muaji shtator kur ishte zgjedhur, akoma vazhdon ta ketë koeficientin 9 si udhëheqës i divizionit, ka kërkuar me shkrim nga K.B që ky vendim të zbatohet, i njëjti asnjëherë nuk kishte marrë përgjigje, takime fizike më asnjëherë nuk kishte pasur, dhe se asnjëherë nuk e kishin ftuar në takim Bordi. Ndihet i dëmtuar emocionalisht, shpirtërisht përtej aspektit material sepse ndryshimi i koeficienti nga 10 në 9 ka qenë diku 60 euro dhe për gjithë këta muaj që nuk është ekzekutuar ky vendim mund të jetë mbi 600 euro, kurse pengesa tjetër që ishin shkaktuar nga mosekzekutimi i këtij vendimi ishte pamundësia që të aplikoj edhe në pozita të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues. Vendimi nuk ishte zbatuar derisa ishte anuluar, në gusht të vitit 2022 kishte pranuar një vendim nga L.A-njësia e burimeve njerëzore, i cili vendimin e anulonte vendimin për zgjedhjen e tij si Drejtor i Departamentit për Trashëgiminë Materiale, i cili vendim ishte si rezultat i një vendimi të Gjykatës së Apelit dhe një vendimi të Bordit, dhe se vendimi i Apelit kishte të bënte me një konkurs kur i njëjti ishte zgjedhur si udhëheqës ekzekutiv në vitin 2018, dhe në bazë të vendimit

nuk e kishte mandatin 3 vite, kështu që mandati i tij vetëm kishte përfunduar si udhëheqës ekzekutiv, pra vendimi i Apelit kishte ardhur një vit e disa muaj pasi dëshmitari e kishte përfunduar mandatin si udhëheqës ekzekutiv. Në web-faqen e gjykatës, e kishte vërejtur një vendim të Apelit i cili e kishte hedhur poshtë kërkesën e K.B për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe për këtë e kishte kërkuar nga Bordi që të zbatohet vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për pagesën e ndryshimit të koeficientit. Zyra e burimeve njerëzore ka pasur mundësi që ta sistemoj me koeficient 10 pa qenë një pozitë me koeficient të tillë, konsideron se kishte një shpërfaqje të qëllimit që i njëjti të mos sistemohet definitivisht në pozitën e drejtorit të departamentit dhe është larguar koeficienti 10 për vitin 2022, mendon me propozimin e Kreshnikut dhe aprovimin e Bordit, koeficientin e kishte larguar Ministria e Financave e cila kërkon që të hartohen qarkoret buxhetore, ky largim i koeficientit mendon se ishte i qëllimshëm që i njëjti të largohej dhe mos të sistemohej në pozitën e drejtorit të departamentit, me zyrën e burimeve njerëzore, konkretisht me A.S lidhur me çështjen e koeficientit nuk është që kishte pasur biseda, kishin mundur me u taku dhe me i qa hallet për shkak se nuk po sistemohet, vendimit për emërimin si drejtor i departamentit e deri në anulimin e këtij vendimi kishte zgjatur 10 muaj e 21 ditë, zyrtari i Burimeve Njerëzore menjëherë pas marrjes së Vendimit që ka pasur të bëjë me të njëjtin i cili është në dispozitivin e kësaj Aktakuze e ka pezulluar punën si Zyrtar i Burimeve Njerëzore, kishte ekzistuar një vendim i Gjykatës Themelore që e kishte anuluar vendimin e KPMSHC-së, po ashtu kishte pasur edhe një vendim të KPMSHC-së, që përfundon procesi Administrativ lidhur me vendimin e parë, kishte Vendim i cili e anulon vendimin për K.B për ndalesën për 50 % të pagës së K.B, mbi bazën e vendimeve kishte parë që K.B kishte parashtruar kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit për të dyja shkallët e Gjykatës, me datën 04.08.2022, e kishte pranuar një vendim me të cilin ishte Anuluar Vendimi për zgjedhjen e tij si Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale, gjithashtu kishte pranuar edhe Aktemrimin me të njëjtën datë për caktimin e tij si Udhëheqësi Divizionit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale. Pasi që i kishte skaduar mandati, me datën 08.09.2021, nuk kishte qenë Udhëheqës Ekzekutiv kurse me datën 13.09.2021, Bordi kishte zgjedhur si zëvendësues K.B. Ka shtuar se e kishte për obligim Njesia e Burimeve Njerëzore, pas mbarimit të pozitës si Udhëheqës ekzekutiv i Divizionit ta sistemoj në një pozitë tjetër brenda Institucionit, vendimi për zgjedhjen e tij si Udhëheqës Ekzekutiv ka qenë nga data 29.01.2018, e deri me datë 29.01.2021, ka kërkuar sqarim nga Ministria e Administratës Publike se si të veprohet bazuar në këtë situatë që e ka KTTK-ja, është pranuar një opinion që është thënë që Udhëheqësi Ekzekutiv vazhdon deri në një emërim tjetër, në këtë çështje ndihet i dëmtuar, tani nuk ka informacion nëse ekziston koeficienti 10 në këtë pozitë.

Dëshmitarja Sh.R në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se qëndron pranë deklaratës të dhënë më herët në këtë çështje penale dhe shtoi se sa i përket pyetjes se nëse një udhëheqësi ekzekutiv në institucion i mbaron mandati si të veprohet, a i ndërrohet pozita apo largohet nga puna, e njëjta është përgjigjur se në kohën kur i është kërkuar një mendim nga Këshilli i Trashëgimisë Kulturore, kishte qenë në pozitë të zëvendësues së drejtoreshës në Drejtorinë e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, përgjigjja e saj kishte qenë se që nga hyrja në fuqi e ligjit, nuk kishin aprovuar asnjë kërkesë e që kuptohet se nuk kishin marrë asnjë kërkesë nga Këshilli pasi është organ i pavarur dhe nuk ka të drejtë e as obligim që të kërkojë aprovimin apo miratimin e ndonjë pozite, ndërsa në deklaratën e dhënë në prokurori kishte thënë se “në pajtim me ligjin për zyrtar publik, në momentin që i përfundon mandati i një pozite të mandatit të lartë të nivelit drejtues dërgohet drejtor ekzekutiv, sekretar i përgjithshëm, e që në këtë rast vlerësoi që pozita e tillë e kanë e nivelit të lartë drejtues, dhe se Institucioni përkatës ka pasur për obligim që të sistemoj në ndonjë pozitë më të ulët drejtuese të nivelit të mesëm drejtues e nëse nuk ka pozitë të nivelit të mesëm, drejtuesi vendoset në pozitën e nivelit profesional”. Ka shtuar se që të emëroj përgjegjësinë për qeverinë e ka Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve



Publik, e në rastin konkret që kuptohet e ka pasur Njësia e Burimeve Njerëzore në kuadër të atij Institucioni, në asnjë dispozitë ligjore nuk përcaktohet që të caktohet që organet jashtë Ekzekutivit të Qeverisë që të kërkoj miratimin apo miratimin për pozitën për sistemim të zyrtarëve të nivelit të lartë drejtues. Institucion jashtë Ekzekutivit nuk kishte ndodhur që të kenë kërkuar sqarim si të veprohet dhe të ju drejtohet për Miratim apo Aprovim të ndonjë pozite të nivelit drejtues, ndërsa në rastin konkret pyetja ka qenë që a keni aprovuar pozitë të tillë, dhe pyetja që i është drejtuar ka qenë e pa qartë dhe e përgjysmuar.

Dëshmitari A.S, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në KKTK-ë ka qenë zyrtar i lartë i personelit prej 2021 deri sa kishte dhënë dorëheqje në mars 2022 apo 2023, e kishte nxjerr vendimin me numër Akti-14/2021 të datës 09.09.2021, lidhur me emërimin e nëpunësit civil në pozitën e kategorisë së mesme drejtuese për I.K, ai vendim nuk ishte zbatuar, kishte kërkuar zyrtarisht nga K.B dhe nga Bordi që të zbatohet ai vendim, kishte qenë përgjegjës që t'i përgatit të gjitha listat e pagave, dhe të njëjtat i dërgonte te K.B për aprovim, në të njëjtën e-mail i kishte bërë tri kërkesa për ndryshim të pagave, njëra kishte qenë zëvendësimi për pagë nga I.K, nga pozita e Udhëheqësit Ekzekutiv në Drejtor i departamentit për MTM, tjetra ishte ndryshimi i pagës i K.B nga Udhëheqësi i Divizionit në Zëvendësues të Udhëheqësit Ekzekutiv, ndërsa kërkesa e tretë kishte qenë zbritja e pagës për dëshmitarin (A.S) sepse kishte qenë në pushim mjekësor pa pagesë, dhe se është aprovuar vetëm kërkesa ku është dashur dëshmitarit të ja heqin pagën për pushimin pa pagesë dy të tjerat nuk ishin zbatuar. Ka shtuar se pasi që ishte kthyer nga pezullimi i punës së tij i ishte hequr kompetenca që e kishte pasur dhe ishte dërguar te një zyrtar tjetër që nuk kishte pas kualifikim. Lidhur me këtë çështje ka dhënë deklaratë në Polici me datë 08.02.2022 dhe qëndron pranë saj, kishin qenë dy pozita me koeficientin 10 në KKTK-ë, njëri kishte qenë për Zyrtarin Financiar dhe tjetra kishte qenë e lirë. Ka shtuar se Bordi e kishte njoftuar se më datën 08.09.2021, ishte vendosur që të hapet konkurs dhe që të mos i vazhdohet të dëmtuarit mandati si Udhëheqës Ekzekutiv dhe e kishte pranuar e-mailin nga Kryetarja e Bordit Z.H, e cila kishte kërkuar sqarime se kush kishte të drejtë t'i ushtrojë detyrat e udhëheqësit zëvendësuesit, pas këtij noftimi dëshmitari ka caktuar të dëmtuarin si drejtor Ekzekutiv pasi që në atë kohë kompetencat për emërimin, zëvendësimin e stafit civil ishte kompetencë e Njesisë së Burimeve Njerëzore, ndërsa kompetencë e Bordit ishte Shpallja e vendimit për Trashëgimin Kulturore dhe aprovimin e konkursit për udhëheqës Ekzekutiv dhe jo për staf, ishte e paraparë edhe pozita e Drejtorit të Departamentit, nuk kishte kërkuar nga Ministria e Administratës Publike aprovimin e kësaj pozite, nuk kishte parashtruar kërkesë për pezullim të vendit të punës para datës 08.09.2021, pasi ishte kandidat për zgjedhje lokale në Graqanicë dhe kishte pas obligim ligjor të jepte dorëheqje. E ka pohuar se akti me nr.14/2021, i datës 09.09.2021, lidhur me emërimin e I.K se është vendimi i tij, ndërsa i është pezulluar puna, pas vendimit, ishte në dijeni që kishte qenë i anuluar vendimi, kishte një Aktgjykim të Gjykatës me të cilin ishte anuluar vendimi që e anulon konkursin dhe kishte qenë vet pjesë e KKTK-së. Në pyetje të akuzuarit K.B, dëshmitari përgjigjet, me Aktvendimin Acnr.1563/19 datë 18.12.2020 të Gjykatës së Apelit mbi shfuqizimin e vendimit të Gjykatës Themelore me të cilin është vërtetuar vendimi i KPMSHCK për anulimin e konkursit për I.K, dëshmitari u përgjigj se e dinte që bazohet në vendimet e fundit gjyqësore, dëshmitari ishte caktuar për herë të parë si udhëheqës i personelit me vendim të I.K, kur kishte marr vendimin 14/2021, kishte qenë nga pozita e Zyrtarit të Lart të Personelit. Ka shtuar se I.K dhe H.D i plotësojnë kushtet për emërimin e pozitës e zëvendësuesit në KKTK-së, ky rekomandim nga ana e dëshmitarit kishte qenë kur kishte pasur të bënte me pozitën e zëvendësit të Udhëheqësit Ekzekutiv e cila kishte qenë e lirë, mirëpo më vonë ishte emëruar K.B, në vitin 2021 kishin qenë 2 pozita me koeficient 10, ndërsa në vitin 2022, kishte qenë vetëm 1 pozitë, sipas planifikimit të buxhetit.

Dëshmitari H.D në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se qëndron pranë deklaratës së dhënë në Prokurori me datë 26.05.2022, në KKTK-ë pozita e tij ishte Zyrtar i Lartë Financiar,

konfirmimi i buxhetit, ndërsa hierarkia ishte e planifikuar, buxheti ishte i përcaktuar sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës, Kuvendi i Kosovës ka emëruar 7 anëtare të bordit dhe në atë vendim ishin caktuar vlerat me të cilat kompensohen, sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës, sa i përket sekretariatit i cili përbëhet prej udhëheqësit ekzekutiv, i cili e kishte koeficientin më të lartë në shërbimin civil, pas udhëheqësit ekzekutiv me vendim dhe aktvendim të ministrisë së administratës publike, pozita e tij kishte koeficientin 10, menjëherë pas kryetarit ekzekutiv, pas kësaj vijonë udhëheqësit e divizioneve me koeficient 9, sipas qarkores së vitit 2021, buxheti ndahej dy qarkoreve që i bie se qarkorja e parë e vitit 2021, kishin qenë të planifikuara dy pozita me koeficient 10, njëra pozitive kishte qenë e lirë, ku kishte qenë i planifikuar edhe dokumenti i planifikimit të buxhetit nga Ministria e Financave. I.K në atë kohë e kishte udhëhequr ekzekutivin deri në shtator të vitit 2021. Bordi i Këshillit ishte themeluar me datën 07.07.2021, I.K pozitën e udhëheqësit ekzekutiv e kishte mbajtur deri në shtator të vitit 2021, për koeficientin 10, qarkorja 2021/01 ishte dorëzuar në Ministrinë e Financave për të gjithë stafin dhe bordin e KKTK-së, sa i përket pyetjes se dokumenti i cili i ishte ofruar në shikim “Formulari i shpenzimeve të departamentit, divizionit ose sektorit të administrimit të programit, klasifikimit dhe organizmit”, se a ishte i përpiluar nga ana e tij dhe cila kishte qenë arsyeja, dëshmitari është përgjigjur se qarkorja 01 në mungesë të Bordit aprovohej prej udhëheqësit dhe Zyrtarit Financiar e cila ishte përpiluar prej të njëjtit dhe udhëheqësit ekzekutiv I.K, për periudhën e vitit 2021 dhe se ky planifikim nuk kishte qenë ndonjëherë në rend të ditës në Bordin e Këshillit, pasi që nuk kishte Bord, ndërsa pas themelimit të Bordit ky dokument nuk i ishte kërkuar ta dorëzonte para Bordit I.K, nuk kishte marrë pjesë në mbledhje as nuk e kishte konsultuar askush. Nuk kishte dijeni se kush kishte marrë vendim, pasi ishte jashtë vendit në atë kohë, e kishte parë vendimin me numër 14/21, pas disa ditëve, për buxhetin e vitit 2022, ishte vendosur në vitin 2021, për të njëjtin kishin vendosur udhëheqësit ekzekutiv të KKTK-së, prej vitit 2022, buxheti kishte kaluar përmes Bordit dhe përmes tij vendoset. Pozitën e Zëvendësit të Udhëheqësit Ekzekutiv në Këshill e kishte marrë K.B nga data 13.09.2021, për këtë ekziston njoftimi përmes emailit. Konfirmimi buxhetor për vendimin nr.14/21 nga Burimet Njerëzore për I.K koeficienti 10, nuk kishte shkuar te i njëjti për t’u ekzekutuar. Ka shtuar se sa i përket A.S i cili kishte nxjerrë vendimin 14/21, me koeficientin 10, për I.K, nuk i kishte shkuar asnjë dokument, ndërsa e kishte pyetur A...lidhur me këtë, i njëjti ishte përgjigjur përmes e-mailit me datë 31.12.2021 se në planifikim të buxhetit ishte e planifikuar dhe i përcaktuar koeficienti, ndërsa nuk ishte në dijeni se a mundej dhe a lejohej që të bëhet pagesa prej një kod buxhetor në tjetrin pa miratimin e thesarit dhe se a ishte kërkuar prej ministrisë apo prej thesarit.

Dëshmitarja Z.H në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se qëndron pranë deklaratës së dhënë në Prokurori me datën 31.05.2022, ka njohuri mbi rregulloren 01/2016, është përgjegjësi dhe mandat i Bordit që të marr vendime që lidhen me shërbyes civil, Bordi ka të drejtë të vendos dikë udhëheqës të departamentit, çdo vendim që ka të bëjë edhe që përmendet me shërbyes civil, i miratonte Bordi sipas rregullores së lartcekur dhe atë të nenin 9, me datën 08.09.2021, kishte vendim dhe kishin diskutuar shkaku që ish udhëheqësi ekzekutiv I.K, kishte pasur të drejtë me marr edhe një mandat, si Bord kishin marrë disa e-maila me vendime të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës se asnjëherë nuk ishte aprovuar nga Bordi i kaluar, që në pozitën që ishte zgjedhur I.K kishte qenë në mënyrë të paligjshme dhe neve nuk ishte ofruar asnjë informatë nga A.S, si njësi e personelit dhe në atë mbledhje e kishin shqyrtuar për validitetin për atë vendim të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës si dhe A.S kishte deklaruar se kjo çështje ishte e mbyllur dhe nuk gaboni, mirëpo më vonë kishte dal e kundërta sipas vendimit të Gjykatës Themelore, dhe se me këto dyshime kishin vendosur që i njëjti mandat të mos vazhdohej, por e kishin lënë që ta shqyrtonin në mbledhje tjetër edhe për ushtrues detyre, e dinte shumë mirë se e kishte pyetur, sepse e kishte konsideruar udhëheqës ekzekutiv dhe i kishte thënë se ta pyeste A.S, sepse për dëshmitaren dhe për Bordin kishin qenë udhëheqës ekzekutiv deri më 13.09.2021, ishte e vërtetë se i kishte

dërguar e-mail A.S dhe e kishte pyetur për procedura dhe për kandidatin i cili mund të jetë ushtrues detyre, por nuk kishte marrë përgjigje, ndërsa zëvendësues i udhëheqësit ekzekutiv ishte zgjedhur K.B me datën 13.09.2021. Në pyetjen e mbrojtësit të akuzuarit K.B dëshmitari është përgjigjur se ekziston vendim që KPMShC që e anulon pozitën e udhëheqësit ekzekutiv për I.K dhe kishte vendim për anulimin e konkursit për I.K, po ashtu ekziston një vendim me të cilin K.B, iu ishin ndaluar 50 % e pagës vendimi i KPMShC për anulimin mbi vendimin mbi ndalimin e pagës për 50 % të K.B. Ka shtuar se e kishte pranuar si Bord Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit me nr.574/2021, për pozitën e I.K të datës 07.06.2022, për bordin dhe vendimi 16/2022, dhe atë nga zyra e Burimeve Njerëzore, e kishte pranuar njoftimin lidhur me urdhrin përmbarrimor CP.nr.1516 /2018, i dt. 20.09.2018, i plotfuqishëm me datë 18.12.2020, të lëshuar nga Gjykata e Apelit nga zyra e Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë.

I akuzuari K.B në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në polici dhe në prokurori. Ka shtuar se e kishte të qartë aktakuzën dhe më datën 13.09.2021, ishte zgjedhur në pozitën e Zëvendësit të Udhëheqësit Ekzekutiv në KTKK-ë, nga Bordi i Institucionit me shumicë votash dhe deri me atë datë sipas Bordit kishte qenë I.K, të njëjtin nuk e kishin shkarkuar deri në datën që e kishin lajmëruar të akuzuarin ndërsa vendimin që e kishte bërë zyrtari i personelit A.S ishte në kundërshtim me rregulloren dhe pa e njoftuar organin më të lartë vendimmarrës, i cili është më nr.14/2021 i datës 09.09.2021, në kohën kur realisht kishte qenë në atë pozitë dhe të cilën e ka kryer deri me datën 13.09.2021, dhe si provë për këtë është se ky e kishte marr pagën deri më atë datë. Vendimi nuk i ishte dorëzuar dhe nuk e kishte njoftuar as A.S dhe as I.K nuk ia kishte dorëzuar dhe askush nga Bordi nuk e kishte pasur atë vendim dhe për më tepër A.S e kishte pezulluar detyrën dhe nuk kishte shkuar në punë pas atij vendimi që e kishte marr. Pra ai ishte vendimi me të cilën ishte pezulluar puna e A.S të cilën ja kishte aprovuar I.K ndërsa si dëshmi e kishte edhe aprovimin për pezullimin e vendit të punës të A... nga I.K, ndërsa në shqyrtim gjyqësor si A... ashtu dhe I.K kishin aluduar në mënyra të ndryshme se kinse i akuzuari e paska larguar nga detyra A.S. Ishte njoftuar nga I.K përmes e-mailit dikur nga fillimi i nëntorit të vitit 2021, nuk ia kishte bashkangjitur në e-mailin por kishte thënë se është sistemuar në kategorinë e mesme drejtuese dhe se ishte ankuar se nuk e kishte marr pagën, ishte ankuar në KPMShC dhe pastaj e kishte marr një vendim prej atij institucioni të cilën e kishte marr A.S nuk ishte në harmoni me rregulloren e punës neni 9.5 dhe neni 9.12 pastaj edhe neni 11.3 të cilat janë të lidhura me rregulloren 01/2016. Procedura nuk ishte ndjekur, këtu thuhet se Bordi i miraton të gjitha vendimet neni 9.5 dhe neni 9.3 thotë miraton buxhetin e KTKK-së, neni 9.12 thotë se mbikëqyr mbarëvajtjen e sekretariatit, dhe se ai vendim nuk kishte kaluar në Bord, dhe në atë mbledhje nuk kishte marr pjesë dhe nuk ishte paraqitur. Për vendimin A.S nuk ishte konsultuar dhe nuk e kishte pyetur Zyrtarin Kryesor Financiar se a kishte mjete të mjaftueshme për këtë pozitë, e as nuk e kishte marr miratimin e DMZP- Departamenti për menaxhimin e zyrtarëve publik, ku për çdo pozitë duhej të bëhej kërkesë ku edhe sot ekziston kjo pozitë dhe nuk mund të lejohet asnjë pozitë pa aprovimin e tyre, për aprovim të pozitave sepse është procedurë ashtu, beson se këto janë arsye për mos veprim sepse ishte një vendim i fshehur mes I... dhe A... dhe i njëjti vendim ishte vërtetuar se ishte i paligjshëm dhe ishte anuluar nga institucioni jonë dhe nga vendimet e gjykatave dhe nga vet KPMShC-ë. Se vendimi në fjalë ishte i paligjshëm, mënyra e veprimit kishte qenë shumë e dyshimtë nga ana e A... sepse të akuzuarit i kishte bllokuar 2 muaj në institucion sepse kishte vazhduar edhe një herë kishte kërkuar pezullim. Problemet me I.K kishin qenë edhe më herët para se të vinte dhe KPMShC-ja e kishte anuluar vendimin pasi e kishte shqyrtuar atë pasi që bordi i KTKK-së si organi më i lartë vendimmarrës kishte marr një vendim dhe e kishte shqyrtuar këtë vendim për ta zbatuar vendimin e Gjykatës AA.nr. 574/2021, vendimi e kishte anuluar edhe konkursin me të cilin ishte zgjedhur në atë pozitë dhe privilegjet e të cilit ka synuar t'i merrte. Shtoi se Bordi e ka marr vendimin me nr.16/2022, për zbatimin e këtij Aktgjykimi pastaj ka pasuar Vendimi me nr.17/2022, i KTKK-së që e ka anuluar Vendimin

nr.14/2021, dhe asnjë prej këtij vendimi për të cilën akuzohet nuk janë në fuqi dhe të cilat nuk kanë mundur as që të zbatohen. Bordi siç edhe është e cekur edhe në rregulloren e buxhetit të KKTK-së e ka miratuar për vitin 2022 në tetor të vitit 2021 dhe aty nuk është paraparë pozita, prandaj kur është marr vendimi në KPMSHC-ë i dhjetorit me të cilën e miratojnë ankesën ndërsa më vonë është Vendimin me të cilën anulohet ky vendim. Gjatë vitit 2022 ky koeficient nuk ka ekzistuar, në tetor të vitit 2021 është miratuar buxheti nga bordi. Pasi që është anuluar ky koeficient dhe është në aktakuzën me të cilën akuzohet dhe në vitin 2021 janë format e PCF-së – planifikimit të buxhetit që këtë e kanë shkruar vet I.K dhe Zyrtari Kryesor Financiar asnjëherë nuk është paraqitur në lëndë. Sa i përket këtij vendimi sikur i dëmtuari ta kishte pasur mandatin legjitim është edhe një vendim tjetër i Gjykatës Themelore i cili është përmbarimor e për të cilën e ka njoftuar edhe Kryetarja e Gjykatës Themelore dhe problemet e pozitës nuk i ka pasur me të akuzuarin, i ka pasur edhe ma herët qysh kur iu ka anuluar pozita me një vendim të KPMSHC-së me shenjë A.nr.257/20189 të datës 19.06.2018 dhe për të cilën ka edhe vendim të procedurës përmbarimore CP.nr.1516/2018 i datë 19.01.2021, është edhe një aktvendim tjetër AC.nr.1563/2019, i datës 18.12.2020, me të cilin Gjykata e Apelit ia ka anuluar pozitën e tij deri sa ka ardhur vendimi përmbarimor. Ka shtuar se nuk e kishte përdorë pozitën, edhe tani dihet por edhe atë here është ditur se nuk kishte ekzistuar dhe nuk kishte pasur ligjshmëri ai vendim 14/2021, dhe pse e kishte mbrojtur ligjshmërinë lidhur me vendimin nr.14/21 por prap se prap ishte akuzuar. Deklaroi se ishte sanksionuar me 50 % të pagës nga kryetari i KPMSHC J.K që është i afërt i I.K dhe ky vendim ishte anuluar edhe nga KPMSHC-ja, për arsye se vendimi i parë për të cilën ishte sanksionuar me 50 % te pagës nuk kishte qenë i drejtë, dhe kur ishte fjala te aludimi se ishte i dëmtuar I.K ishte kthyer në pozitën dhe se vet e kishte kthyer në pozitën të cilën e kishte pasur, konsideron se ishte e vërtet se nuk e kishte dëmtuar I..., ndërsa sa i përket pikës 2 të aktakuzës deklaroi se nuk kishte bërë kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit kishte refuzuar këtë pjesë dhe jo vendimin përfundimtar sa i përket ankesës, sepse vet KPMSHC-ja kishte kërkuar nga Gjykata Administrative pezullimin e procedurës sepse çështja ka qenë pa objekt. Deklaroi se asnjëherë nuk e kishte dëmtuar I.K dhe asnjë tjetër, i njëjti ishte kthyer në pozitën që ka qenë dhe për krahasim i njëjti kur e kishte marrë pozitën e Udhëheqësit në vitin 2018 nuk i ishte ofruar asnjë pozitë udhëheqëse dhe deklaroi se nuk ishte dëmtuar, kishte aluduar se kishte dashur ta largonte nga puna se i njëjti ishte sot e kësaj dite e ka pranuar këtë pozitë edhe është i punësuar. Në pyetje të prokurorit i akuzuari deklarohet se, në vitin 2021 formulari që ishte nënshkruar nga I.K i cili nuk kishte kaluar në bord dy pozita me koeficient 10, edhe po ta kishte koeficientin 10 askush nuk ta merrte pa u aprovuar pozita në bord, buxhetin e miraton bordi ku hyjnë të gjitha si dhe koeficiente, deklaroi se ishte zgjedhur me datën 13.09.2021, mirëpo buxheti i vitit 2021 nuk ishte miratuar asnjëherë dhe ky dokument i PFC-së nuk kishte kaluar në bord dhe e kishte nënshkruar e I.K dhe H.D, kryetarja e bordit kishte deklaruar se ky formular nuk kishte kaluar në bord. Ishte emëruar nga Kuvendi i Kosovës në fillim të korrikut të vitit 2021, buxheti miratohet para se të filloi viti dhe kur e përcakton bordi në rend të ditës. Rregullorja e përmendur në këtë proces gjyqësor është rregullore për punën e KKTK-së, pra kjo rregullore nuk është rregullorja e klasifikimit dhe sistematizimit për të cilën po aludon prokurori dhe vet si dëshmi e kishte e-malin e I.K ku i kishte thënë Kryetares se e kishte rregulloren që nga viti 2010, ku kjo pozitë nuk ishte në përputhje me rregulloren e re, për vitin 2022. Ka shtuar se sigurisht që do ta zbatonte vendimin pasi që ishte paraparë një koeficient 10. Për vendimin objekt i aktakuzës i cili ishte në emrin e I.K si drejtor i departamentit nga Njësia e Burimeve njerëzore, për kohën për të cilën i referohet i dëmtuari, A.S kishte qenë i pezulluar dhe se ekziston prova, në vitin 2021 dhe A... kishte qenë i caktuar për listën e pagave dhe deklaroi se nuk kishte njohuri se i njëjti ishte pezulluar pasi që kishte filluar punën në shtator të vitit 2021 dhe nuk e kishte ditur se ku ishte A... Vendimin e KPMSHC-së, të dhjetorit të vitit 2021 nuk po e konteston pasi që ai vendim ishte anuluar. Sa i përket kësaj pozite në fjalë i kishte thënë për paligjshmërinë e mëhershme të vendimit gjatë viteve 2021 dhe 2022, raporti i auditorit asnjëherë nuk kishte gjetur

asnjë shkelje për të cilën pretendonte i dëmtuari dhe pse i njëjti kishte deklaruar disa herë, pasi që të gjitha këtu duke përfshirë çështjet financiare, auditori nuk ka gjetur ndonjë shkelje.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata duke vlerësuar të gjitha provat një nga një dhe të gjitha së bashku, në përputhje me nenin 360 të KPPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata nga të gjitha provat e lartcekura materiale dhe personale gjeti këto rrethana jo kontestuese:

Kontestuese nuk ishte për gjykatën se i akuzuari K.B për kohën për të cilën akuzohet ka qenë në marrëdhënie pune në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe se me datë 13.09.2021 është emëruar në pozitën e Zëvendësit të Udhëheqësit Ekzekutiv e që në këtë pozitë e ka pasur cilësinë e personit zyrtar për kohën për të cilën akuzohet sipas aktakuzës së prokurorisë.

Për Gjykatën kontestuese ishte fakti nëse i akuzuari duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, nuk i ka përmbushur detyrat e tij zyrtare, me qëllim që të përfitojë çfarëdo dobie për vete ose personin tjetër, apo t'i shkaktoj dëme personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër, përkatësisht moskryerja me dashje e ndonjë detyrë të domosdoshme të përcaktuar me ligj, përfshirë këtu edhe mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Faktet e tilla kontestuese gjykata i ka zgjidhur pas administrimit të provave personale dhe materiale.

Gjykata pas administrimit të provave personale dhe materiale gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor por edhe provave tjera që gjenden në shkresat e lëndës si dhe deklaratave të dëshmitarëve I.K, Sh.R, A.S, H.D dhe Z.H, ka ardhur në përfundim se nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari K.B ka kryer veprat penale në vazhdimësi, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.3 pika 1 lidhur me par.1 dhe nenin 77 të KPPRK-së dhe veprës penale në vazhdimësi, Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore nga neni 394 par.1 lidhur me nenin 77 të KPPRK-së.

Gjykata nga dëshmia e dëshmitarit I.K ka vërtetuar se Vendimi me nr.14/21 i datës 09.09.2021, i marr nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, me të cilin vendim I.K ishte emëruar në pozitën e kategorisë së mesme drejtuese Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Materiale me koeficient 10, ndërsa në Gusht të vitit 2022, ishte nxjerrë një vendim tjetër nga Njësia e Burimeve Njerëzore ku është anuluar Vendimi për caktimin e tij si Drejtor Departamentit dhe ishte caktuar si Udhëheqës i Divizionit, i cili vendim ishte si rezultat i një vendimi të Gjykatës së Apelit, prova materiale këto të elaboruara në pjesë të aktgjykimit.

Gjykata nga dëshmia e dëshmitares Sh.R ka vërtetuar se lidhur me pyetjen që i ishte parashtruar se nëse një udhëheqësi ekzekutiv në institucion i mbaron mandati si të veprohet, a i ndërrohet pozita apo largohet nga puna, e njëjta është përgjigjur se në kohën kur i është kërkuar një mendim nga Këshilli i Trashëgimisë Kulturore, e njëjta kishte qenë në pozitë të zëvendësues së drejtoreshës në Drejtorinë e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, përgjigjja e saj kishte qenë se që nga hyrja në fuqi e ligjit, nuk kishin aprovuar asnjë kërkesë e që kuptohet se nuk kishin marrë asnjë kërkesë nga Këshilli pasi është organ i pavarur dhe nuk ka të drejtë e as obligim që të kërkojë aprovimin apo miratimin e ndonjë pozite.

Gjykata nga dëshmia e dëshmitarit A.S ka vërtetuar se në KKTK-ë ka qenë zyrtar i lartë i personelit prej 2021 deri sa kishte dhënë dorëheqje, si udhëheqës i personelit me vendim të I.K, i njëjti e kishte nxjerr vendimin me numër Akti nr.14/2021 të datës 09.09.2021, lidhur me

emërimin e nëpunësit civil në pozitën e kategorisë së mesme drejtuese për I.K. Bordi e kishte njoftuar se më datën 08.09.2021, ishte vendosur që të hapet konkurs dhe që të mos i vazhdohet të dëmtuarit mandati si Udhëheqës Ekzekutiv dhe e kishte pranuar e-mailin, nuk kishte kërkuar nga Ministria e Administratës Publike aprovimin e kësaj pozite, pasi ishte kandidat për zgjedhje lokale në Graçanicë dhe kishte pas obligim ligjor të jepte dorëheqje, pas vendimit e kishte pezulluar punën si zyrtar i lartë i personelit, ishte në dijeni që kishte qenë i anuluar vendimi, kishte një Aktgjykim të Gjykatës me të cilin ishte anuluar vendimi që e anulon konkursin. Po ashtu ishte në dijeni se Aktvendimi Acnr.1563/19 datë 18.12.2020 i Gjykatës së Apelit mbi shfuqizimin e vendimit të Gjykatës Themelore me të cilin është vërtetuar vendimi i KPMSHCK për anulimin e konkursit për I.K, që bazohet në vendimet e fundit gjyqësore,

Gjykata nga dëshmia e dëshmitarit H.D ka vërtetuar se pozita e tij në KKTK-ë ishte Zyrtar i Lartë Financiar, konfirmimi i buxhetit, ndërsa hierarkia ishte e planifikuar, buxheti ishte i përcaktuar sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës, pozita e tij kishte koficientin 10, menjëherë pas kryetarit ekzekutiv, pastaj vijnë udhëheqësit e divizioneve me koeficient 9, sipas qarkores së vitit 2021, buxheti ndahej dy qarkoreve, ndërsa prej vitit 2022, buxheti kishte kaluar përmes Bordit dhe përmes tij vendoset. Pozitën e Zëvendësit të Udhëheqësit Ekzekutiv në Këshill e kishte marrë K.B nga data 13.09.2021. Konfirmimi buxhetor për vendimin nr.14/21 nga Burimet Njerëzore për I.K koeficienti 10, nuk kishte shkuar te i njëjti për t'u ekzekutuar.

Gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike po ashtu nga dëshmia e dëshmitares Z.H e cila ka deklaruar se Zëvendës i Udhëheqësit Ekzekutiv ishte zgjedhur K.B me datën 13.09.2021, ekziston vendimi që KPMSHC që e anulon pozitën e udhëheqësit ekzekutiv për I.K dhe kishte vendim për anulimin e konkursit për I.K, po ashtu ekziston një vendim me të cilin K.B, iu ish in ndaluar 50 % e pagës, pastaj Vendimi i KPMSHCK për anulimin mbi vendimin mbi ndalimin e pagës për 50 % të K.B. Si Bord Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit me nr.574/2021, për pozitën e I.K të datës 07.06.2022, për bordin dhe vendimi 16/2022, dhe atë nga zyra e Burimeve Njerëzore, e kishte pranuar njoftimin lidhur me urdhrin përmbarimor CP.nr.1516 /2018, i dt. 20.09.2018, i plotfuqishëm me datë 18.12.2020, të lëshuar nga Gjykata e Apelit nga zyra e Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, si Bord kanë konstatuar që në pozitën që ishte zgjedhur I.K kishte qenë në mënyrë të paligjshme, e gjitha kjo pas vendimeve të Gjykatës.

Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se deklaratat e dëshmitarëve Sh.R, H.D dhe Z.H, ishin të besueshme, kredibile dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën dhe provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, ashtu që të njëjtave ia fali besimin lidhur me deklaratimet e tyre, pasi që në dëshmitë e asnjërit prej tyre në asnjë moment të vetëm, me deklarinimin e tyre përgjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në procedura tjera nuk e inkriminojnë të pandehurin K.B.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e prokurorit të shtetit të paraqitura në fjalën e tij përfundimtare, mirëpo e njëjta nuk ishte e bazuar në provat materiale dhe me deklaratat e dëshmitarëve të cilët i ka propozuar dhe janë dëgjuar në shqyrtim gjyqësor.

Sa i përket pretendimeve të dëmtuarit të paraqitura në fjalën e tij përfundimtare, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk kishin relevancë për çështjen e cila është objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor, pasi që edhe e vet e ka pohuar se me Vendimin e KKTK-së i është anuluar vendimi për emërimin e tij në pozitën e kategorisë së mesme drejtuese-Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Materiale me koeficient 10.

Gjykata po ashtu vlerësoj edhe fjalën përfundimtare të mbrojtësit dhe të akuzuarit, për çka gjeti se të njëjtat janë të bazuara në provat materiale dhe me deklaratat e dëshmitarëve H.D, Sh.R dhe

Z.H, të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor, rezultojnë se me të drejtë nuk u provua se i akuzuari të ketë kryer veprat penale, të cilat janë objekt i aktakuzës.

Nga të gjitha këto rrethana për gjykatën rezulton se provat që mbështesin aktakuzën nuk krijojnë dyshimin e bazuar për elementet e veprave penale për të cilën akuzohet i akuzuari, më saktësisht me asnjë prove që prokuroria e mbështet aktakuzën nuk rezulton ekzistimi i dyshimit të bazuar, dhe as nga faktet e çështjes nuk rrjedh ekzistimi i ndonjë qëllimi që përmes ushtrimit të autorizimit të tij, i akuzuari K.B si Zëvendës i Udhëheqësit Ekzekutiv në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, të ketë pasur qëllim që duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin e tij zyrtar në mënyrë të vazhdueshme, që të përfitojë çfarëdo dobie për vete ose personin tjetër, apo t'i shkaktojë dëme personit tjetër ose që seriozisht ti shkel të drejtat personit tjetër, përkatësisht mos përmbushja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj, e si pasojë gjatë kësaj periudhe me dashje të ketë refuzuar zbatimin e ekzekutimit të Vendimit për pagesën e ndryshimit të pagës për të dëmtuarin I.K, e të cilat Vendime gjatë këtij procesi gjyqësor veç se ishin anuluar. Vlen të cekët këtu Vendimi-Akti.Nr.17/22 i datës 03.08.2022 i lëshuar nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore me të cilën ka anuluar Vendimin me nr.14/2021 të datës 09.09.2021 (objekt i akuzës), për emërimin e nëpunësit civil në pozitën e kategorisë së mesme drejtuese të I.K, e që ky vendim ka rezultuar nga Vendimi Akt.nr.16/22 i datës 28.07.2022 i lëshuar nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore për anulimin e konkursit me të cilin ishte emëruar Udhëheqës Ekzekutiv I.K, e gjithë kjo bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.nr.574/2021 të datës 07.06.2022 dhe Vendimi nr.257/2018 i datës 19.06.2018 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke obliguar KKTK-së, gjegjësisht Udhëheqësit Ekzekutiv që t'i ndërmerr të gjitha veprimet ligjore për zbatimin e këtij vendimi si dhe kthimin e ligjshmërisë së procesit dhe evidentimin e shkeljeve ligjore.

Po ashtu nga të gjitha këto rrethana për gjykatën rezulton se me asnjë provë të cilat mbështesin akuzën nuk rezulton ekzistimi i dyshimit të bazuar, dhe as nga faktet e çështjes nuk rrjedh ekzistimi i dashjes që i akuzuari K.B në cilësi të personit zyrtar në mënyrë të vazhdueshme ka refuzuar të ekzekutojë vendimet e cekura në pikën II të dispozitivit të akuzës, pasi që gjatë procesit janë administruar provat materiale saktësisht Vendimin me nr.69/2022 i datës 08.08.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me të cilin ka Shfuqizuar Vendimin Nr.03/2022 të datës 14.02.2022 lidhur me ndalën e 50% të pagës për K.B, Zëvendës i Udhëheqësit Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, andaj bazuar në të gjitha vendimet e organeve kompetente të kyçura në këtë rast gjatë rrjedhjes së procedurës vie në përfundim të qartë se akuza në pikën e dytë të dispozitivit është e paqëndrueshme dhe farë nuk ka të bëjë me elementet e veprës penale nga neni 394 par.1 të KPRK-së, sepse nuk ka të bëjë me moszbatim të vendimit gjyqësor por ka pasur të bëjë më vetëm me propozimet e prolongimit e afateve e të cilat më vonë kanë rezultuar të jenë të drejta.

Vështruar nga cilësimi juridik i veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 par.3 pika 3 lidhur me par.1 të KPRK-së, kjo vepër penale ekziston kur personi zyrtar a përgjegjës, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat e tij zyrtare me qëllim që të përfitojë për vete a për tjetrin çfarëdo dobie, i shkakton dëm tjetrit ose shkel seriozisht të drejtat e personit tjetër dhe moskryerja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj, pra veprimi i kryerjes është përcaktuar në mënyrë alternative dhe vepra penale paraqitet në tri forma, që janë: shfrytëzimi i pozitës zyrtare (shpërdorim) apo autorizimeve, tejkalimi i autorizimeve zyrtare dhe mos përmbushja e detyrave zyrtare (moskryerja e detyrimeve zyrtare).

Gjykata ka gjetur se veprimet e të akuzuarit ishin brenda kompetencave të tij ligjore që dalin nga detyrat e tij të punës dhe në qoftë se i njëjti kishte vepruar ashtu siç pretendon prokuroria do të

rezultonte me mos përmbushjen e detyrave të tij zyrtare. Prandaj sipas vlerësimit të gjykatës në rastin konkret me provat e propozuara dhe të zbatuara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, andaj gjykata në nenin 363 par.1 nënpar 1.3 të KPPRK-se vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj, nga të gjitha këto që u thanë më lartë, e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPP-së, parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin “in dubio pro reo”, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. E në ndërlidhje me këtë, po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “in peius” ndaj të pandehurit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë “in favorem” ndaj të pandehurit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet. Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të pandehurit dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohej si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të pandehurin, e cila është në kundërshtim esencial të njërës prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ.

Po ashtu gjykata ua fali besimin në tërësi mbrojtjes së dhënë nga i akuzuari, për faktin se deklaratat e tij janë kuptimplote dhe se i njëjti ka deklaruar në mënyrë të njëjtë gjatë të gjitha fazave të procedurës penale, i cili ka deklaruar se nuk e ka përdorë pozitën, pasi që edhe atëherë ishte ditur por edhe tani është ditur se nuk kishte ekzistuar dhe nuk kishte pasur ligjshmëri Vendimi nr.14/2021, i cili është anuluar me Vendimin nr.17/2022, të KTTK-së dhe asnjë prej këtij vendimeve për të cilat akuzohet nuk janë në fuqi dhe të cilat nuk kanë mundur as që të zbatohen dhe se nuk e ka dëmtuar I.K pasi që të njëjtin e kishte kthyer në pozitën që ka qenë dhe se një gjë e tillë argumentohet edhe nga provat tjera, që janë proceduar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, me deklarinimin e vet të dëmtuarit si dhe me dëshmitë e dëshmitarëve si dhe faktin se nga provat materiale nuk u vërtetua se i akuzuari ka ndërmarrë ndonjë veprim i cili mund të cilësohet keqpërdorim i detyrës apo autoritetit të tyre zyrtar apo mosbazitim i vendimeve të cilat më vonë janë anuluar.

Pra nga të gjitha këto gjykata konstaton se nuk ka prova për të mbështetur dyshimin e bazuar mire dhe përtej këtij dyshimi se i akuzuari K.B të ketë kryer veprat penale për të cilat ngarkohet me akuzë dhe jo çdo dyshim është i mjaftueshëm për të ngritur aktakuzë nga ana e Prokurorit të Shtetit apo edhe për ta shpallur fajtor të akuzuarin, por duhet të ekzistoi një shkallë tejet e lartë e dyshimit, përkatësisht duhet të ekzistojë dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat akuzohej. Një gjë e tillë është parashikuar në disa dispozita ligjore por vlen të përmendet neni 234 të KPPRK-së. Në nenin 234 par.1 të KPPRK-së është parashikuar se “për tu ngritur aktakuzë duhet të ekzistojë një dyshim i bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale”. Pra për tu ngritur aktakuza duhet që të ekzistojë “dyshimi i bazuar mirë” dhe është detyrim i Prokurorit të Shtetit, që gjykatës t’ia argumentoi se ekziston një dyshim i tillë gjë që në këtë çështje penale nuk është vepruar në këtë mënyrë pasi që të gjitha provat si ato të propozuara nga prokuroria si dhe ato nga mbrojtja, të dorëzuara nga i dëmtuari në shqyrtim gjyqësor, e të cilat secila veç e veç si në lidhmëni me njëra tjetrën dëshmojnë pafajësinë e të akuzuarit lidhur me veprat penale për të cilat akuzohet nga prokuroria.



Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor vlerësoi pretendimet e Prokurorisë por e njëjta nuk arriti të argumentoj me fakte dhe prova para gjykatës elementet e veprës penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.3 pika 1 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KRPRK-së dhe veprës penale, Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore nga neni 394 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me të cilat vepra ngarkohej i akuzuari, ngase nga provat e administruara nuk gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohen elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprave penale, e që përbëjnë figurën e veprave penale të cekura më lartë për të akuzuarit, për të cilat akuzohej, andaj nisur nga të gjitha këto që u thanë gjykata pasi analizoi dhe vlerësoi provat e administruara dhe mbrojtjen e të akuzuarit nuk gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohet elementet e veprave penale të lartcekura dhe në mungesë të provave dhe mos ekzistimit të elementeve të veprës penale, konform nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së, të akuzuarin për veprat penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e liroi nga akuza.

Gjykata, rikujton se sipas nenit 48 të KPPRK-së, prokurori i shtetit ka për obligim që gjatë hetimit të veprave penale të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese, dhe të sigurojë që një hetim të kryhet duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit dhe që mbledhja e provave të mos bëhet në kundërshtim me Kapitullin XVI të këtij kodi. Gjithashtu, duke u bazuar në nenin 234 të KPPRK-së, përcaktohet se në akuzë duhet të jepen shpjegimet e arsyeshme për ngritjen e akuzës, bazuar në rezultatin e hetimeve dhe provave që i vërtetojnë faktet kryesore. Në rastin konkret prokuroria, nuk kishte siguruar prova të mjaftueshme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte do të mund të vërtetohej se i akuzuari K.Bka kryer veprat penale që akuzohej.

Gjykata, bazuar në arsyet dhe faktet e cekura si më lartë vendosi që të pandehurin K.B, në mungesë të provave, t`a lirojë nga akuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për veprën penale në vazhdimësi: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.3 pika 1 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe veprën penale në vazhdimësi, Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore nga neni 394 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pakontestueshme, në favor dhe disfavor të të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPRK-së, parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurve dhe të drejtave të tyre sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Shpenzimet e procedurës:

Kjo Gjykatë në mbështetje të nenit 453 par.1 të KPPRK-së, ka vendosur që shpenzimet e procedurës penale të bie në barrën e buxhetit të gjykatës, ngase kjo dispozitë përcakton në mënyrë shprehimore se kur i akuzuari lirohet nga akuza shpenzimet e procedurës penale nga neni 449 duhet të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës, gjë që në rastin konkret sikurse është vendosur në dispozitiv të akuzuarit janë liruar nga akuza.

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest juridiko – civil, gjykata e mori në bazë të nenit 462 par.1 dhe 3 të KPPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**  
**PKR.nr.335/22, me datë 01.07.2024**

**Zyrtare ligjore**  
**Arxhenita Vokshi**

**Kryetarja e trupit gjykues-Gjyqtarja**  
**Sulltane Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykatë, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.